

PSH.nr.538/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina – Referues dhe z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “AAG PROJEKT & ALPING”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i zhveshtoreve ne Stadiumin e futbollit Demush Mavraj” me nr. të prokurimit: 633-20-1797-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Istog, me datën: 17.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “AAG PROJEKT & ALPING”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndertimi i zhveshtoreve ne Stadiumin e futbollit Demush Mavraj” me nr. të prokurimit: 633-20-1797-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Istog.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i zhveshtoreve ne Stadiumin e futbollit Demush Mavraj” me nr. të prokurimit: 633-20-1797-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Istog, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “AAG PROJEKT & ALPING”- Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues “AAG PROJEKT & ALPING”- Prishtinë që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatoret ekonomik “AAG PROJEKT & ALPING”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 04.08.2020 me nr. 538/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndertimi i zhveshtoreve ne Stadiumin e futbollit Demush Mavraj” me nr. të prokurimit: 633-20-1797-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Istog, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 60 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.08.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 01.09.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim: Eksperti do ti shqyrton vetëm ato pretendime ankimore qe janë ne kërkesën per rishqyrtim sipas Neni 9 - Periudha kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP

9.2 Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t’i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues.

Pretendimi ankimor i OE ankues ne kërkesën per rishqyrtim

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankuesne lidhje me Kërkesën per rishqyrtim

GOE kanë paraqitur një listën e mjeteve të kërkuar në dosje të tenderit e cila plotëson kërkesat e kërkuara në dosje të tenderit pjesërisht pasi që librezat e qarkullimit me kontraktuesin për furnizim me beton janë të skaduara me shume se nje vit.

Sqarim GOE:

Në bazë të vendimit te Qeverise se Kosoves ,përkatësisht te Ministris se Puneve të Mbrendshme te dates 16.03.2020 ku ceket ne web faqe zyrtare te MPB-(<https://mpb.rksgov.net/f/57/57/Njoftim-per-aktivitetet-e>

pezulluara-ne-sherbimet-me-qytetare)për pezullim te regjistrimit te automjeteve si pasoje e pandemise COVID 19, është kërkuar te bëhet vetem sigurimi i automjeteve dhe mundë te lëvizin pa penges, andaj kompania që kemi marrveshje i ka automjete e siguruar siç është e lejuar me vendim te qeverise. Nga data 04.05.2020 automjetet kan qen ne gjendje te rregullt me dokumentacion me polica te sigurimit te cilat kan levize, Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik më të ulët krahasuar me situatën paraprake e konstatuar nga IKSHPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë firma qe kemi qen ne marrveshje per furnizim me beton i ka kryer edhe ne qendren e regjistrimit te cilat mundem ti deshmojme me Libreza te qarkullimit te automjeteve e cila date perputhet me daten e sigurimit te automjetit e cila eshte 04.05.2020-04.05.2021 Për piken e lartëpërmendur i plotesojm kriteret ne baze te kerkesave FDT-se, dhe mendojm se AKse nuk ka qen korrekt ne vlersim.

Pasi kemi kërkuar qasje ne dokumente me date 16.07.2020 për OE fitues na është lejuar qasja, te cilen e kemi bere me daten 17.07.2020 dhe kemi shqyrtu dokumenta e OE ku kemi vrejtur se nuk e permbushë kërkesen e FDT-së piken:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale :

d) Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas Standardit EN-ISO 9001 2019

- d) Kopja e certifikatës valide.

OE ne dosjen e tenderit ka ngarkuar Çertifikatë EN-ISO 9001 2015 e cila ka validitet deri me 27.06.2020 dhe ku shihet se Çertifikates i ka kaluar afati i skadimit dhe AK ka bere "Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues.pdf :633-20-1797-5-2-1" ka ardhur ne emila me date: 16.07.2020 ne e-prokurim pa e plotsuar ket kriter .

Duke ju referuar argumenteve te cekura me larte ne kerkojme qe te anulohet vendimi per dhenje e kontrates per OE fitues dhe te na shpallin fitues ne si GOE fitues te pergjegjshem me qmim me te ulet.

Përgjigje ne pretendimet ankimore

Përgjigje nr.1

Eksperti i OSHP-se lidhur me pretendimin e pare ankimor sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se Në bazë të vendimit te Qeverise se Kosoves ,përkatësisht te Ministrisë se Puneve të Mbrendshme te dates 16.03.2020 ku ceket ne web faqe zyrtare te MPB-(<https://mpb.rks-gov.net/f/57/57/Njoftim-per-aktivitetet-e-pezulluara-ne-sherbimet-me-qytetare>) për pezullim te regjistrimit te automjeteve si pasoje e pandemise COVID 19, është kërkuar te bëhet vetem sigurimi i automjeteve dhe mundë te lëvizin pa penges, andaj kompania që kemi marrveshje i ka automjete e siguruar siç është e lejuar me vendim te qeverise. Nga data 04.05.2020 automjetet kan qen ne gjendje te rregullt me dokumentacion me polica te sigurimit te cilat kan levize, Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik më të ulët krahasuar me situatën paraprake e konstatuar nga IKSHPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e

Qeverisë firma që kemi qenë në marrëveshje për furnizim me beton i ka kryer edhe në qendrën e regjistrimit të cilat mundem ti dëshmojmë me Librezë të qarkullimit të automjeteve e cila datë perputhet me datën e sigurimit të automjetit e cila është 04.05.2020-04.05.2021 Për piken e lartëpërmendur i plotësojmë kriteret në bazë të kërkesave FDT-se, dhe mendojmë se AK-se nuk ka qenë korrekt në vlerësim.

Hapja e ofertës me dt.28.05.2020, pasi që hapja është bërë në pandemi MPB, konkretisht Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve nuk kanë kryer punën e vet për shkak të Pandemisë me dt.16.03.2020 MPB ka dalë me njoftim për shkak të pandemisë nuk janë kryer shërbimet nga Agjensioni i regjistrimit Civil(citim):
Agjencia për Regjistrim Civil

Ka mbyllë Qendrat për Pajisje me Dokumente (QPD) dhe Qendrat për Regjistrimin e Automjeteve (QRA) në Komunën e Vitisë, Klinës dhe Malishevës.

Aplikimi për letërnjoftim, pasaportë dhe patentë – shoferë si dhe regjistrimi i automjeteve, përjashtimisht QPD-ve dhe QRA-ve të përmendura më lart, bëhet vetëm për rastet urgjente mjekësore; Tërheqja e letërnjoftimit, pasaportës dhe patentë – shoferit, bëhet vetëm në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë;

Po ashtu, apostilimi dhe verifikimi i dokumenteve të gjendjes civile bëhet vetëm për rastet urgjente mjekësore dhe terminet e caktuara në ambasadat e huaja në Republikën e Kosovës.

Policia e Trafikut Rrugor do të kenë parasysh për të gjitha rastet për patentë-shofer të skaduar, si dhe automjetet që ju ka skaduar regjistrimi, nga hyrja në fuqi e vendimit të Qeverisë dhe për ato automjete që janë të paregjistruara për shkak se ofrimi i këtyre shërbimeve nga ARC-ja momentalisht është pezulluar.

Kërkesa e AK-se:

Kërkesa 7 – Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit min;
- 1 Eskavator min.12 ton; - 2 Kamion me kapacitet min 10m³ kipper; - 1 Ngarkues me kapacitet min. 1-3m³; - 1 Cilinder me kapacitet min. 12 ton; - 1 Autopompe betoni; - 2 Kamion për transport të betonit të gatshëm me kapacitet min. 10m³;

Dëshmia:

Dëshmia 7. Lista mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike në dispozicion të operatorit ekonomik apo kontratë për huazim të mjeteve për projektin në fjalë, të dëshmohen me librezë të qarkullimit valide ose DUD-it doganor në emër të kompanisë – pronarit ose kontratë për projektin në fjalë me një subjekt tjetër për huazim të mjeteve.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, pasi që për shkak të pandemisë ka patur reduktim të stafit në Shërbimet Publike, konkretisht shërbimet e cekura si në njoftim. Por kërkesa e AK-se ka qenë “Te dëshmohet me librezë të qarkullimit – valide”, pra në rastin konkret Nuk janë valide kopjet e librezave pasi që janë të

skaduara, por OE ne dosjen e tij ne emër te OE AC BETON (qe ka marrëveshje me AAG-PROJEKT), ka te bashkangjitura Kopjet sigurimit te kamionave (mikserve, autopompave etj) te cilat i ka siguruar, por nuk i ka regjistruar per shkak te mbylljes se QRA-ve ne gjithë Kosoven sipas Njoftimit te bashkangjitur me larte.

Pra, duke pasur parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se, propozojmë qe AK ti kërkoj sqarime shtese me arsyen e kursimit te buxhetit te AK-se.

Pra, AK mund te kërkon sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, dhe t'i qartëson mjetet e prezantuara, pasi qe i ka te bashkangjitura kopjet e sigurimit te kamionave, sipas kriterit te kërkuar ne FDT per gjitha pajisjet dhe t'i qartëson sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se.

Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

Pergjigje nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Pasi kemi kërkuar qasje ne dokumente me date 16.07.2020 për OE fitues na është lejuar qasja, te cilen e kemi bere me daten 17.07.2020 dhe kemi shqyrtu dokumenta e OE ku kemi vrejtur se nuk e permbushë kërkesen e FDT-së piken:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale :

d) Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas Standardit EN-ISO 9001 2019

- d) Kopja e certifikatës valide.

OE i rekomanduar ne dosjen e tenderit i ka ngarkuar Çertifikatën EN-ISO 9001 2015 e cila ka validitet deri me 27.06.2020 dhe ku shihet se Çertifikates i ka kaluar afati i skadimit dhe AK ka bere "Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues.pdf :633-20-1797-5-2-1" ka ardhur ne emila me date: 16.07.2020 ne e-prokurim pa e plotsuar ket kriter .

Duke ju referuar argumenteve te cekura me larte ne kërkojmë qe te anulohet vendimi per dhenje e kontrates per OE fitues dhe te na shpallin fitues ne si GOE fitues te pergjegjshem me qmim me te ulet.

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor ne FDT dhe Njoftim per Kontrate, sqaron se ne dosjen e Tenderit kërkohet ky kriter:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale :

d) Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas Standardit EN-ISO 9001 2019

- d) Kopja e certifikatës valide.

Sqarim:

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se OE i rekomanduar ne lidhje me certifikatën ISO 9001-2015, ju sqarojme se OE i rekomanduar ka Certifikata EN ISO 9001-2015 me nr.certifikates W-170645-Q, e lëshuar

ne emër të "MENTI" SHPK që ne rastin konkret është OE i rekomanduar, kjo certifikatë është e lëshuar nga WQR e cila është lëshuar me dt.30.06.2017, data e lëshimit të fundit 28.06.2019, kurse data e përfundimit të periudhës 29.06.2020.

OE ofertues në datën e ofertimit (dt.29/05/2020) ka pasur Certifikatën valide, edhe pse i ka kaluar pas hapjes me dt.29.06.2020 (30 dite pas hapjes). Ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me lartë), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe në fazën e rivlerësimit t'i kerkohen sqarime shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datën 01.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 01.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues "AAG PROJEKT & ALPING"- Prishtinë, se në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të datës 16.03.2020, ku ceket në ueb faqen zyrtare të MPB-së:

(<https://mpb.rks-gov.net/f/57/57/Njoftim-per-aktivitetet-e-pezualluara-ne-sherbimet-me-qytetare>), për pezullim të regjistrimit të automjeteve si pasojë e pandemisë COVID 19, është kërkuar të bëhet vetëm sigurimi i automjeteve dhe mund të lëvizin pa pengesë, andaj kompania që kemi marrëveshje i ka automjete e siguruar siç është e lejuar me vendim të qeverisë. Nga data 04.05.2020 automjetet kanë qenë në gjendje të rregullt me dokumentacion me polica të sigurimit të cilat kanë lëvizë. Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet me rrezik më të ulët krahasuar me situatën paraprake e konstatuar nga IKSHPK dhe zyra e OBSH-së në Kosovë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë firma që kemi qenë në marrëveshje për furnizim

me beton i ka kryer edhe në qendrën e regjistrimit të cilat mundem ti dëshmojm me libreza të qarkullimit të automjeteve e cila datë përputhet me datën e sigurimit të automjetit e cila është 04.05.2020-04.05.2021. Për pikën e lartë përmendur i plotësojmë kriteret në bazë të kërkesave të FDT-së dhe mendojm se AK nuk ka qenë korrekt në vlerësim. Më tej, OE ankues shton se hapja e ofertës është bërë me dt.28.05.2020 dhe pasi që hapja është bërë në pandemi, MPB konkretisht Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve nuk kanë kryer punën e vet për shkak të pandemisë, me dt.16.03.2020 MPB ka dal me njoftim për shkak të pandemisë nuk janë kryer shërbimet nga Agjensioni i regjistrimit Civil (citim): Agjencia për Regjistrim Civil

Ka mbyllë Qendrat për Pajisje me Dokumente (QPD) dhe Qendrat për Regjistrimin e Automjeteve (QRA) në Komunën e Vitisë, Klinës dhe Malishevës.

Aplikimi për letërnjoftim, pasaportë dhe patentë – shoferë si dhe regjistrimi i automjeteve, përjashtimisht QPD-ve dhe QRA-ve të përmendura më lart, behët vetëm për rastet urgjente mjekësore; Tërheqja e letërnjoftimit, pasaportës dhe patentë – shoferit, behët vetëm në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë;

Po ashtu, apostilimi dhe verifikimi i dokumenteve të gjendjes civile behët vetëm për rastet urgjente mjekësore dhe terminët e caktuara në ambasadat e huaja në Republikën e Kosovës. Policia e Trafikut Rrugor do të kenë parasysh për të gjitha rastet për patentë-shofer të skaduar, si dhe automjetet që ju ka skaduar regjistrimi, nga hyrja në fuqi e vendimit të Qeverisë dhe për ato automjete që janë të paregjistruara për shkak se ofrimi i këtyre shërbimeve nga ARC-ja momentalisht është pezulluar.

Kërkesa e AK-se:

Kërkesa 7 – Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit min;

- 1 Eskavator min.12 ton; - 2 Kamion me kapacitet min 10m³ kipper; - 1 Ngarkues me kapacitet min. 1-3m³; - 1 Cilinder me kapacitet min. 12 ton; - 1 Autopompe betoni; - 2 Kamion per transport te betonit te gatshem me kapacitet min. 10m³;

Dëshmia 7. Lista mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjeve teknike ne dispozicion te operatorit ekonomik apo kontrate per huazim te mjeteve per projektin ne fjale, te dëshmohen me libreza te qarkullimit valide ose DUD-it doganor ne emër te kompanisë – pronarit ose kontratë per projektin ne fjale me një subjekt tjetër për huazim te mjeteve.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pasi që për shkak të pandemisë ka pasur reduktim të stafit në shërbimet publike, konkretisht shërbimet e cekura si në njoftim por kërkesa e AK-së ka qenë që “Të dëshmohet me libreza të qarkullimit – valide”, pra ne rastin konkret nuk janë valide kopjet e librezave pasi që janë të skaduara. Por, OE në dosjen e tij në emër të OE AC BETON (që ka marrëveshje me AAG-PROJEKT), ka të bashkangjitura kopjet sigurimit të kamionave (mikserve, autopompave, etj.) të cilat i ka siguruar, por nuk i ka regjistruar për shkak të mbylljes së QRA-ve në gjithë Kosovën sipas njoftimit të bashkangjitur më lartë. Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke pasur parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së, konsideron se AK duhet të kërkoj sqarime shtesë me arsyen e kursimit të buxhetit të

AK-së. Për më tepër, AK mund të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe t'i qartëson mjetet e prezantuara, pasi që i ka të bashkangjitura kopjet e sigurimit të kamionave, sipas kriterit të kërkuar në FDT për të gjitha pajisjet dhe t'i qartëson sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-s. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "AAG PROJEKT & ALPING"- Prishtinë se pasi kemi kërkuar qasje në dokumente me datë 16.07.2020 për OE fitues dhe na është lejuar qasja, të cilën e kemi bërë me datën 17.07.2020 dhe kemi shqyrtuar dokumentet e OE ku kemi vërejtur se nuk e përmbush kërkesën e FDT-së, pikën:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale :

d) Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas Standardit EN-ISO 9001 2019

- d) Kopja e certifikatës valide.

OE i rekomanduar në dosjen e tenderit i ka ngarkuar Çertifikatën EN-ISO 9001 2015 e cila ka validitet deri me 27.06.2020 dhe ku shihet se Çertifikates i ka kaluar afati i skadimit dhe AK ka bërë "Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues.pdf :633-20-1797-5-2-1" ka ardhur ne email me datë: 16.07.2020 ne e-prokurim pa e plotësuar këtë kriter. Duke ju referuar argumenteve të cekura më lartë ne kërkojmë që të anulohet vendimi për dhënie të kontratës për OE fitues dhe të na shpallin fitues ne si GOE fitues të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin ankimor, në FDT dhe në njoftimin për kontratë, si dhe në dosjen e tenderit kërkohet ky kriter:

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale: d) Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas Standardit EN-ISO 9001 2019; - d) Kopja e certifikatës valide.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar në lidhje me certifikatën ISO 9001-2015, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar ka Certifikata EN ISO 9001-2015 me numër të certifikates W-170645-Q, e lëshuar në emër të "MENTI" SHPK që në rastin konkret është OE i rekomanduar, kjo certifikate është e lëshuar nga WQR e cila është lëshuar me dt.30.06.2017, data e lëshimit të fundit 28.06.2019, kurse data e përfundimit të periudhës 29.06.2020. OE i rekomanduar në datën e ofertimit (dt.29/05/2020) ka pasur certifikatën valide, edhe pse i ka kaluar pas hapjes me dt.29.06.2020 (30 dite pas hapjes). Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të OE ankues, sqarimeve të ekspertit shqyrtues, si dhe vendimit të MPB-së për pezullim të regjistrimit të automjeteve si pasojë e pandemisë COVID 19, vjen në përfundim se pretendimi i OE ankues në lidhje me regjistrimin e kamionëve dhe mjeteve tjera është pjesërisht i bazuar. Mirëpo, duke pasur parasysh vendimin dhe udhëzimet e Ministrisë së Punëve të

Brendshme, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Komuna Istog
- 1x1 OE -"AAG PROJEKT & ALPING"- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.